

RENDI I DITËS
i
ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT TË VETËM
të
BKT PAY SHA

Do të mbahet të mërkurën, më datë 26 Qershor 2024, ora 16:00, në Zyrat Qendrore të Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) në Tiranë, Shqipëri.

Pikat e mëposhtme do të merren parasysh:

- (1) Miratimi i njoftimit të shkurtër.
- (2) Miratimi i pasqyrave financiare për vitin financiar 2023.
- (3) Emërimi i audituesit të jashtëm.
- (4) Rritja e kapitalit aksionar të BKT Pay SHA.
- (5) Ndryshime të Statutit të BKT Pay SHA.
- (6) Të tjera.

/ .

mm

PROCESVERBALI

i

ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT TË VETËM

të

BKT PAY SHA

- Data, ora dhe vendi i mbledhjes:** 26 Qershor 2024, ora 16:00, në Zyrat Qëndrore të Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) në Tiranë, Shqipëri.
- Thirrur nga:** Këshilli i Administrimit
- Përfaqësuesi:** **Z. Seyhan Pencabliligil**, Administrator dhe Drejtor i Përgjithshëm i Banka Kombëtare Tregtare SHA, sipas Statutit të Aksionarit të Vetëm (100% e aksioneve).
- Kryetari:** **Znj. Bilgen Aldan** u thirr për të drejtuar këtë Asamble të Përgjithshme të Aksionarëve.
- Sekretari:** Kryetari ftoi **Znj. Ketjona Aliaj** të kryejë detyrën e sekretares.
- Kuorumi:** Kryetari verifikoi se aksionari që përfaqëson të gjithë kapitalin aksionar të shlyer të BKT PAY SHA u përfaqësua në mbledhje dhe se rrjedhimisht kuorumi për mbledhjen plotësohej dhe të gjitha vendimet mbi çështjet e renditura në rendin e ditës mund të miratoheshin.

VENDIMET

Përfaqësuesi i Aksionarit të Vetëm ra dakord të votojë në favor të vendimeve të mëposhtme:

- (1) Që Aksionari i Vetëm pranon njoftimin e shkurtër.

Vendim: Aksionari i Vetëm **MIRATOI** vendimin.

- (2) Në përputhje me Nenin 11.1(k) të Statutit dhe në përputhje me Nenin 135.2(dh) të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, që Aksionari i Vetëm miraton pasqyrat vjetore financiare për vitin financiar 2023, të miratuara dhe paraqitura nga Këshilli i Administrimit.

Vendim: Aksionari i Vetëm **MIRATOI** vendimin.

- (3) Në përputhje me Nenin 11.1(h) të Statutit dhe në përputhje me Nenin 135.2(ç) të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, që Aksionari i Vetëm miraton emërimin e Mazars SHPK me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga "Emin Duraku", Pallati "Binjaket" Nr. 5,

Kati I teknik, Ap. 1&2, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS K32123006W, si auditor i jashtëm për vitin financiar që përfundon më 31 Dhjetor 2024.

Vendim: Aksionari i Vetëm **MIRATOI** vendimin.

- (4) Në përputhje me Nenin 11.1(c) të Statutit dhe në përputhje me Nenin 135.2(ë) të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, që Aksionari i Vetëm miraton rritjen e kapitalit aksionar të BKT PAY SHA nëpërmjet emetimit të 122,625 (njëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) aksioneve të reja, me vlerë nominale LEK 1,141.70 (një mijë e njëqind e dyzet e një e shtatë të dhjetat), të barabarta me LEK 140,000,962.50 lekë (njëqind e dyzet milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy e pesë të dhjetat).

Kapitali aksionar përpara ndryshimit Kapitali aksionar i nënshkruar dhe i paguar plotësisht i BKT Pay është EUR 2,300,000 (dy milionë e treqind mijë euro), i ndarë në 230,000 (dyqind e tridhjetë mijë) aksione me vlerë nominale EUR 10 (dhjetë euro).

Kapitali aksionar pas ndryshimit Kapitali aksionar i nënshkruar dhe i paguar plotësisht i BKT Pay është:

- EUR 2,300,000 (dy milionë e treqind mijë euro), të ndara në 230,000 (dyqind e tridhjetë mijë) aksione me vlerë nominale EUR 10 (dhjetë euro); dhe,
- LEK 140,000,962.50 (njëqind e dyzet milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy e pesë të dhjetat), të ndara në 122,625 (njëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) aksione, me vlerë nominale LEK 1,141.70 (një mijë e njëqind e dyzet e një e shtatë të dhjetat).

Vendim: Aksionari i Vetëm **MIRATOI** vendimin.

- (5) Në përputhje me Nenin 11.1(a) të Statutit dhe në përputhje me Nenin 135.2(b) të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, që Aksionari i Vetëm miraton ndryshimin e Statutit të BKT Pay SHA pas rritjes së kapitalit aksionar. Konkretisht, neni 5 i Statutit të BKT Pay SHA do të ndryshohet si më poshtë:

Neni 5 para ndryshimit Kapitali aksionar i Shoqërisë, i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht, është 2,300,000 EUR (dy milionë e treqind mijë euro), i ndarë në 230,000 (dyqind e tridhjetë mijë) aksione me vlerë nominale 10 EUR (dhjetë euro).

Neni 5 pas ndryshimit Kapitali aksionar i Shoqërisë, i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht, përbëhet nga 230,000 (dyqind e tridhjetë mijë) aksione me vlerë nominale 10 EUR (dhjetë euro) dhe 122,625 (njëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) aksione, me vlerë nominale 1,141.70 LEK (një mijë e njëqind

e dyzet e një e shtatë të dhjetat lekë) që janë të barabarta përkatësisht me:

(a) 2,300,000 EUR (dy milionë e treqind mijë euro),
dhe

(b) 140,000,962.50 LEK (njëqind e dyzet milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy e pesë të dhjetat lekë).

Vendim: Aksionari i Vetëm **MIRATOI** vendimin.

- (6) Në përputhje me Nenin 11.1(a) të Statutit dhe në përputhje me Nenin 135.2(b) të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, që Aksionari i Vetëm miraton ndryshimin e nenit 9.2 të Statutit të BKT Pay SHA si më poshtë:

| | |
|--------------------------|---|
| Neni 9.2 para ndryshimit | Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet të paktën një herë në vit, për miratimin e pasqyrave financiare vjetore, brenda 3 (tre) muajve pas përfundimit të vitit financiar. |
| Neni 9.2 pas ndryshimit | Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet të paktën një herë në vit, për miratimin e pasqyrave financiare vjetore, brenda 6 (gjashtë) muajve pas përfundimit të vitit financiar. |

Vendim: Aksionari i Vetëm **MIRATOI** vendimin.

- (7) Në përputhje me Nenin 11.1(a) të Statutit dhe në përputhje me Nenin 135.2(b) të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, që Aksionari i Vetëm miraton ndryshimin e nenit 17.5 të Statutit të BKT Pay SHA si më poshtë:

| | |
|----------------------------|---|
| Neni 17.5. para ndryshimit | Auditimi i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga kontabilistë të autorizuar, të emëruar për një vit fiskal nga Asambleja e Përgjithshme. |
| Neni 17.5 pas ndryshimit | Auditimi i jashtëm i Shoqërisë kryhet nga kontabilistë të autorizuar, të emëruar për një vit fiskal nga Asambleja e Përgjithshme. |

Vendim: Aksionari i Vetëm **MIRATOI** vendimin.

- (8) Që Administratori të autorizohet të drejtojë dhe mbikëqyrë procedurat për regjistrimin e vendimit me autoritetet përkatëse në Shqipëri.

Vendim: Aksionari i Vetëm **MIRATOI** vendimin.

[PJESA E MBETUR E FAQES LËNË QËLLIMISHT BOSH –
FAQJA E NËNSHKRIMIT VIJON]

Nënshkruar nga Përfaqësuesi i Aksionarit të Vetëm, Kryetari dhe Sekretari.

PËRFAQËSUESI

SEYHAN PENCABLIGIL



M. Seyhan Pencabliligil
Administrator dhe Drejtor i Përgjithshëm i Banka
Kombëtare Tregtare SH.A.

KRYETAR

BILGEN ALBAN




SEKRETAR

KETJONA ALIAJ



LISTA E AKSIONARËVE TË PRANISHËM

TË

BKT PAY SHA

(NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT TË VETËM,
TË MBAJTUR NË TIRANË, TË MËRKURË, MË DATË 26 QERSHOR 2024)

BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A.


Adresa: Rr: Rruga e Vilave, Qendra e Biznesit Fusha, Lundër 1,
Tiranë, Shqipëri

Pronësia: 230,000 aksione të zakonshme të barasvlershme me
100% të aksioneve;

Vlera nominale e aksioneve: 10 € për aksion;

Numri i votave: 230,000 vota;

Përfaqësuesi:


M. Sulejman P. P. D.

